



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1189/2Prot.

Tiranë, më 04.12.2023

V E N D I M

Nr. 242, datë 04.12. 2023

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 230, datë 26.10.2023, të paraqitur nga z. Gj. Sh kundër Komisarariatit të Policisë Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shoqërore”, “bindjes politike”, “për çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: *“Jam një invalid pune me shkallë invaliditeti të plotë por vuatjet e mia nuk kanë të sosur si në kohën e diktaturës ashtu dhe tani në demokraci. Si person që i përkas shtresës së persekutuar politikisht ashtu dhe ekonomikisht jemi duke u diskriminuar nga organet publike siç është Komisarati i Policisë Shkodër i cili është një organ shtetëror që ofron shërbime për publikun, ndalohet të diskriminojë shtetasin i cili kërkon të arrijë të marrë një të drejtë, që i rrjedhë nga ekzekutimi i një vendimi gjyqësor. Komisarati i Policisë Shkodër, ashtu siç merr pjesë në ekzekutimin e të gjitha vendimeve gjyqësore të shtetasve shqiptar, duhet të më mbështesë dhe mua si qytetar i lirë i Republikës së Shqipërisë në të drejtën që më jep ligji, për të gëzuar lirisht pronën time dhe ky gëzim mua më vjen duke mu realizuar ekzekutimi i vendimit gjyqësor nga ana e tyre.*

Si shtetas i RSH-së, kërkoj që nga Komisarati i Policisë Shkodër të trajtohem në mënyrë të barabartë me të gjithë shtetasit e tjerë të Shqipërisë që është një e drejtë Kushtetuese që të gjithë shtetasit të jenë të barabartë para ligjit. Mosekzekutimi i vendimit vjen dhe si pasojë e bindjeve të

mia politike, pasi personave që kanë zënë pronën time sa herë ka fushatë elektorale i kërkohet vota si këmbim i mosnxjerjes nga banesa ku ata po banojnë dhe unë jam përsëri në kushtet e persekutimit.

Më poshtë po parashtroj të gjithë kronologjinë e veprimeve dhe mosveprimet e bëra nga subjektet:

Unë kam në pronësi një sipërfaqe toke, truaill me sipërfaqe 1486,65 m² dhe 548,25 m² ndërtesë, ish-Shkollën e Rezervave Shkodër, e cila ndodhet në lagjen “Skëndërbeg”, rruga “Nënë Tereza”, Zona Kadastrale nr. 8593.

Kjo pasuri është përfituar nga ana ime fillimisht përmes Vendimit nr.1158, datë 05.07.1996 të KKKP, pranë Bashkisë Shkodër dhe në vijim kontratës së shitjes, lidhur midis Ministrisë së Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike dhe Bashkia Shkodër, në cilësinë e shitësit si dhe meje Gjon Shkambi në cilësinë e blerësit.

Kjo pasuri aktualisht figuron e rregjistruar në favorin tim në rregjistrat hipotekor të pasurive të paluajtshme të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër.

Pavarsisht faktit se kjo pronë rezulton në pronësinë time, unë ende nuk kam ushtruar asnjë moment tagrat e mia si pronar. Kjo për shkak se në këtë pasuri janë strehuar në mënyrë të paligjshme disa familje, të cilët janë posedues të paligjshëm të pasurisë time dhe të cilët nuk kanë asnjë tagër për ushtrimin e këtij posedimi.

Për të realizuar të drejtat e mia të pronësisë unë i jam drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me Vendimin nr. 119, datë 27.03.2002 më ka njohur që kjo pronë të më kthehet mua. Po kështu me Vendimin nr. 20, datë 28.06.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër, në lidhje me këtë vendim është lëshuar urdhëri i ekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor.

Në lidhje me këtë vendim me datën 22.09.2022 i jam drejtuar Zyrës së Përmbartimit Shkodër për ekzekutimin e këtij vendimi.

Shpjegoj se pavarsisht veprimeve të kryera nga Përmbartuesi Gjyqësor T. M, ekzekutimi i këtij vendimi nuk është kryer edhe në këtë moment. Shkak i mosekzekutimit janë veprimet e shefave të Komisarariatit të Policisë Shkodër dhe konkretisht shtetasit A. Sh dhe në vijim shtetasi I. D, persona të cilët edhe pse janë njoftuar zyrtarisht dhe rregullisht nga Përmbartuesi Gjyqësor në mënyrë të përsëritur, duke i kërkuar mbështetje bazuar në nenin 523 të K.Pr.Civile, ata kanë refuzuar përmbushjen e këtij detyrimi ligjor, duke u bërë në këtë mënyrë pengesë e drejtpërdrejtë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor dhe shkak për vijimin e cënimit të të drejtës time të pronësisë.

Në mënyrë të përmbledhur po i pasqyroj këto mosveprime si më poshtë:

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore ka filluar mbi bazën e kërkesë time të datës 22.09.2022 drejtuar Zyrës së Përmbartimit Shkodër. Kjo e fundit me shkresën nr. 2158 prot., datë 13.10.2022 ka njoftuar personat e tretë të cilët mbajnë sendin, për ekzekutimin vullnetar të vendimeve gjyqësore.

Në datën 31.10.2022 unë i jam drejtuar përsëri me kërkesë Zyrës Përmbartimore Shkodër, duke i kërkuar marrjen e sendit nga personat e tretë që e mbajnë atë, në funksion të ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Po në datën 31.10.2022, Zyra e Përmbartimit Shkodër ka kaluar në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm (neni 519 i K.Pr.Civile).

Me shkresën nr. 2614 prot., datë 31.10.2022, Përmbartuesi Gjyqësor ka njoftuar Komisarlatin e Policisë Shkodër, duke i kërkuar mbështetjen për ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

Me shkresën nr. 6909/1 prot., datë 03.11.2022 Komisarlati i Policisë Shkodër, njofton përmbartuesin gjyqësor se policia e rendit e këtij Komisarlati nuk do t'i mbështesë në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, me arsyetimin se: Struktura e Komisarlatit të Policisë Shkodër në asnjë rast nuk ka marrë pjesë dhe nuk mund të marri përsipër të bëjnë komentimin apo argumentimin ligjor të vendimeve gjyqësore, por referuar Vendimit nr. 105, datë 27.03.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nuk citohet ndonjë urdhërim i caktuar gjyqësor mbi banorët e individualizuar në atë pasuri të paluajtshme (banesa), sikurse kërkohet nga ana juaj, si dhe nuk disponojmë ndonjë vendim të Gjykatës së Apelit lidhur me këtë çështje.....Gjithashtu, nga Përmbartuesi Gjyqësor nuk është bërë njoftimi me shkresë i personave të tretë që banojnë në atë objekt për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, si dhe nuk është sqaruar arsyeja e ndërprerjes dhe kalimi në ekzekutim të detyrueshëm të këtij vendimi.

Me shkresën nr. 2730 prot., datë 04.11.2022 Përmbartuesi Gjyqësor i ka kërkuar përsëri ndihmë dhe mbështetje Komisarlatit të Policisë Shkodër dhe po me shkresën nr. 2731 prot., datë 04.11.2022 Zyra e Përmbartimit Shkodër i ka bërë me dije këtij institucioni se në rast mosveprimi ndaj tij do të merren masa bazuar në nenin 606 të K.Pr.Civile, për gjobitjen e institucionit.

Me shkresën nr. 6980/2 prot., datë 05.11.2022 Komisarlati i Policisë Shkodër ka dërguar të njëjtën përgjigje si me shkresën nr. 6909/1 prot., datë 03.11.2022, të sipërcituar.

Me shkresën nr. 2778 prot., datë 08.11.2022, Zyra Përmbartimore Shkodër i është ridrejtuar Komisarlatit të Policisë Shkodër, duke i kërkuar mbështetje për ekzekutimin e vendimit gjyqësor në favor të personit tim.

Me shkresën nr. 7066/1 prot., datë 16.11.2022 Komisarlati i Policisë Shkodër ka dërguar të njëjtën përgjigje si me shkresën nr. 6909/1 prot., datë 03.11.2022, të sipërcituar.

Me shkresën nr. 3110 prot., datë 24.11.2022 dhe nr. 3646 prot., datë 27.12.2022, Zyra Përmbartimore Shkodër i është ridrejtuar Komisarlatit të Policisë Shkodër, duke i kërkuar mbështetje për ekzekutimin e vendimit gjyqësor në favorin tim.

Me shkresën nr. 8053/2, datë 06.01.2023 Komisarlati i Policisë Shkodër, ka dërguar të njëjtën përgjigje si me shkresën nr. 6909/1 prot., datë 03.11.2022, të sipërcituar. Në këtë shkresë Komisarlati në atë kohë, për të justifikuar mosveprimin e tij i kujton Përmbartuesit Gjyqësor Vendimin nr. 1068, datë 22.07.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore të Përmbartuesit Gjyqësor M. T, ku gjykata ka pranuar padinë e

paditësit M. C, N. C etj., lënë në fuqi me Vendimin nr. 1, datë 07.01.2016 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Në lidhje me këtë qëndrim thekësoj faktin se Vendimi nr. 1068, datë 22.07.2024 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër që i referohet veprimeve përmbartimore të kryera nga një Përmbartues tjetër Gjyqësor (M. T), në një kohë të kaluar dhe konkretisht në vitin 2014, pra 9 vite më parë, por edhe ky vendim aktualisht nuk është në fuqi. Në këtë drejtim evidentoj faktin se edhe pse i njohur me Vendimin nr. 784, datë 24.11.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër e cila i ka konsideruar veprimet e Përmbartuesit Gjyqësor si të rregullta, sërish Shefi i Komisarariatit të Policisë Shkodër ka refuzuar të mbështesë Zyrën e Përmbartimit Shkodër në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

Me shkresën nr. 99, datë 27.12.2022 Zyra e Përmbartimit Shkodër i është ridrejtuar Komisarariatit të Policisë Shkodër, duke i kërkuar mbështetje për ekzekutimi e vendimit gjyqësor në favorin tim, e cila me shkresën nr. 1723 prot., datë 16.01.2023 ka dërguar të njëjtën përgjigje si me shkresën nr. 6909/1 prot., datë 03.11.2022, të sipërcituar.

Theksoj se nga procesverbalet e mbajtura nga Përmbartuesi Gjyqësor të datave 04.11.2022, 07.11.2022, 18.11.2022, 07.12.2022, 09.01.2023, 25.01.2023, 17.02.2023, 08.03.2023 dhe 12.04.2023 rezulton qartë që në çdo rast mosekzekutimi i vendimit gjyqësor ka ardhur si rrjedhojë e mosmbështetjes së Përmbartuesit Gjyqësor nga Policia e Rendit e Komisarariatit të Policisë Shkodër. Me shkresën nr. 782 prot., datë 20.02.2023 Zyra Përmbartimore Shkodër ka depozituar kallzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndaj Komisarariatit të Policisë Shkodër për kryerjen e veprës penale "Pengim i ekzekutimit të vendimit gjyqësor" të parashikuar nga neni 320 i K.Penal.

Ndërkohë përmbartuesi gjyqësor T. M ka vijuar me veprimet për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, duke vazhduar korrespondencën me Komisarariatit të Policisë Shkodër, pa mbështetjen e të cilit është e pamundur të realizohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor. Me shkresën me nr. 1448 prot., datë 19.04.2023 Zyra Përmbartimore Shkodër ka rikërkuar ndihmë Komisarariatit të Policisë Shkodër për ekzekutimin e Vendimit Urdhër Ekzekutiv nr. 2, datë 28.06.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër, për ekzekutimin e Vendimit nr. 105, datë 27.03.2002 dhe nr. 119, datë 11.02.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke planifikuar si datë ekzekutimi datën 19.05.2023, ora 10.00. Në lidhje me këtë kërkim Komisariatit të Policisë Shkodër, kanë vijuar të mbajnë të njëjtin qëndrim si dhe në të gjitha rastet e sipërcituara. Me shkresën nr. 3447/1 prot., datë 15.05.2023 Përmbartuesi Gjyqësor njoftohet se Komisarariatit të Policisë Shkodër nuk merr përsipër të bëjë komentimin apo argumentimin ligjor të vendimeve gjyqësore, gjë që është tagër e institucioneve shtetërore. Sipas Komisarariatit në vendimin që kërkohet të ekzekutohen nuk citohet ndonjë urdhërim i caktuar gjyqësor mbi banorët e individualizuar në atë pasuri të paluajtshme. Përmes kësaj shkrese Komisariatit kërkon vënien në dispozicion nga Përmbartuesi Gjyqësor të vendimeve gjyqësore, veprim i cili është kryer në mënyrë të përsëritur nga përmbartuesi në çdo rast sa herë është kërkuar mbështetja e Komisarariatit për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, kërkesë e cila qartazi ka si qëllim vetëm zgjatjen e procedurave përmbartimore. Sërish Komisariatit të Policisë Shkodër nuk harron të përmend Vendimin nr. 1068 (2828), datë 22.07.2014 të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Shkodër dhe Vendimin nr. 1, datë 07.01.2016 të Gjykatës së Apelit Shkodër të cilët sipas tij në argumentimin ligjor dhe dispozitiv evidentojnë faktin se nuk ekziston ndonjë urdhër administrativ që detyrojnë familjarët që të lirojnë banesat ku jetojnë, vendime të cilat aktualisht nuk kanë asnjë fuqi ligjore dhe të cilat Komisariati nuk mund t'i referojë në asnjë rast. Nga ana e Komisarariatit nuk përmendet arsytimi dhe disponimi i Vendimit Gjyqësor nr. 784, datë 24.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku gjykata qartazi ka arsyetuar se ekzekutimi i vendimit gjyqësor në fjalë mund të bëhet edhe kundër personave të tjerë, që në rastin konkret janë personat që posedojnë në mënyrë të paligjshme pronën time, disponim ky që e bën qëndrimin e Komisarariatit të Policisë Shkodër haptazi në kundërshtim me të.

Në datën 19.05.2023 Përmbaruesi Gjyqësor ka mbajtur procesverbal nga i cili rezulton mosëkzekutimi i vendimeve gjyqësor për shkak të mosparaqitjes së Policisë së Shtetit dhe përfaqësuesve të pushtetit lokal.

Ndërkohë në datën 19.05.2023 Zyra e Përmbarimit Shkodër ka njoftuar përsëri Komisarariatit e Policisë Shkodër, duke i kërkuar mbështetje me forca policore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, duke caktuar datën 01.06.2023, mbështetje e cila qartësisht nuk do të na jepet as me këtë datë dhe në këtë mënyrë ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që më japin mundësinë të gëzoj, posedoj dhe disponoj lirisht pronën time do të bëhet i pamundur për shkak të qëndrimit në kundërshtim të hapur me ligjin të mbajtur nga Komisariati i Policisë Shkodër.

Në datën 06.07.2023, 07.09.2023, dhe datën 12.10.2023 Zyra e Përmbarimit Shkodër ka njoftuar Komisarariatit e Policisë Shkodër, duke i kërkuar mbështetje me forca policore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, mbështetje e cila qartësisht nuk është dhënë. Në këtë mënyrë ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që më japin mundësi të gëzoj, posedoj dhe disponoj lirisht pronën time është bërë i pamundur për shkak të qëndrimit diskriminues që mban Komisariati i Policisë Shkodër ndaj personit tim për shkak të gjendjes sime shoqërore.

Komisariati i Policisë Shkodër e ka diskriminuar (trajtuar në mënyrë të pabarabartë) kreditorin Gj. Sh.

Të gjitha veprimet apo mosveprimet e paligjshme të sipërpërmendura, ndalohen shpehimisht me ligj dhe konkretisht:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Në nenin 3/1,2,9 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: Diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo

bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”. Po sipas këtij neni “Diskriminimit i drejtpërdrejtë”, është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji. Po sipas këtij neni “Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme, që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore, të njohura në kuadrin ligjor kombëtar, për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji”.

Në nenin 13 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, përcaktohet se: “Çdokush të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhje efektive përpara një organi kombëtar pavarësisht se shkelja e kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

Në nenin 14 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, përcaktohet se: “Gëzimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të parashikuara në këtë Konventë, duhet të sigurohet pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si raca, ngjyra, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

Në nenin 17 të Kushtetutës së R.Sh-së, përcaktohet se: “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtesisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, etnia, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.”

Duke analizuar rrethanat e faktit të mësipërm si dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të lartpërmendura, vlerësojmë se është e qartë se shtetasi Gjon Shkambi ka pësuar diskriminim të drejtpërdrejtë nga Komisariati i Policisë Shkodër”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave që parashikon ligji mbi diskriminimin ndaj institucionit shtetëror Komisarariatit të Policisë së Shtetit Shkodër.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje

me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Referuar informacionit të cituar, me Vendimin nr. 119, datë 27.03.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Vendimin nr. 20, datë 28.06.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër, ankuesit i është njohur dhe kthyer një sipërfaqe toke, trull me sipërfaqe 1486,65 m² dhe 548,25 m² ndërtesë, me emërtimin “ish-Shkollën e Rezervave Shkodër”, e cila ndodhet në Lagjen “Skëndërbeg”, rruga “Nënë Tereza”, Zona Kadastrale nr. 8593 dhe me Vendimin nr. 352 (2819), datë 22.07.2014 “Për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit” të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është urdhëruar ekzekutimi i tyre.

Ndërkohë me shkresën nr. 2614 prot., datë 31.10.2022, Përmbaruesi Gjyqësor ka njoftuar Komisionarin e Policisë Shkodër, duke i kërkuar mbështetjen për ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

Shkresat për mbështetjen për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, janë bërë në mënyrë të përsëritur nga Përmbaruesi Gjyqësor T. M, por përgjigja ka qënë në çdo rast e njëjtë si me shkresën nr. 6909/1 prot., datë 03.11.2022, ku Komisionari i Policisë Shkodër, njofton Përmbaruesin Gjyqësor

se policia e rendit e këtij Komisariati nuk do t'i mbështesë në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, me arsyetimin se: Struktura e Komisarariatit të Policisë Shkodër në asnjë rast nuk ka marrë pjesë dhe nuk mund të marri përsipër të bëjnë komentimin apo argumentimin ligjor të vendimeve gjyqësore, por referuar Vendimit nr. 105, datë 27.03.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nuk citohet ndonjë urdhërim i caktuar gjyqësor mbi banorët e individualizuar në atë pasuri të paluajtshme (banesa), sikurse kërkohet nga ana juaj, si dhe nuk disponojmë ndonjë vendim të Gjykatës së Apelit lidhur me këtë çështje.....Gjithashtu, nga Përmbartuesi Gjyqësor nuk është bërë njoftimi me shkresë i personave të tretë që banojnë në atë objekt për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, si dhe nuk është sqaruar arsyeja e ndërprerjes dhe kalimi në ekzekutim të detyrueshëm të këtij vendimi.

Referuar korrespondencës shkresore të kryer midis Përmbartuesit Gjyqësor T. M dhe Komisarariatit të Policisë Shkodër, të administruar së bashku me ankesën për këtë çështje, rezulton që për rastin objekt shqyrtimi është shprehur dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, shkresë e cila daton që në **28.08.2020** (shkresa nr.779/1 prot.).

Sipas shkresës nr. 779/1 prot., datës 28.08.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, është trajtuar kërkesa nr. 2581/1 prot., datë 06.08.2020 e Komisarariatit të Policisë Shkodër nëpërmjet të cilës është kërkuar mendim në lidhje me “...mosmbështetjen me forca policore të Përmbartuesit Gjyqësor Privat z. L. C”.

Ky fakt vërtetohet dhe në kthimet e përgjigjeve të Komisarariatit të Policisë Shkodër ku ndër të tjera shprehen se: “...për të qenë sa më objektiv në rastin e çështjes konkrete, ka pasur një korrespondencë shkresore të rregullt, në zbatim të detyrimeve ligjore dhe Procedurës Standarte të Punës “Për veprimet që kryhen nga strukturat e Policisë së Shtetit”, në rastin e mbështetjes së Përmbartuesit Gjyqësor Privat/Shtetëror, miratuar me Urdhërin nr. 136, datë 04.02.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit”. Gjithashtu përmendet dhe shkresa nr. 6886/5, datë 04.12.2020 e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila ka trajtuar çështjen lidhur me veprimet dhe qëndrimin që duhet të mbajë Komisariati i Policisë Shkodër, për sa i përket kërkesës së përmbartuesit gjyqësor për rastin e Gj. Sh.

Subjekti ankues ka kërkuar konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave që parashikon ligji mbi diskriminimin ndaj institucionit shtetëror Komisarariatit të Policisë së Shtetit Shkodër.

Ligji nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”, i ndryshuar, në nenin 22, të tij, ka përcaktuar se: “1. Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

2. Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor i ushtron funksionet nëpërmjet përmbartuesve gjyqësorë”.

Pika 1, e nenit 53, të këtij Ligji përcakton se: “Përmbartuesi gjyqësor është personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me

dispozitat e Kodit të Procedurës Civile”.

Neni 354, pika 1, shkronja dh) e ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor”, të ndryshuar, ngarkon me përgjegjësi, me shkarkim nga detyra, përmbarruesin gjyqësor, duke përcaktuar se:

“1.Përmbarruesi gjyqësor shkarkohet nga detyra në këto raste:

a) kur dënohet për kryerjen e një vepre penale;

b) kur kryen shkelje të rënda të disiplinës në punë;

c) kur kryen në mënyrë të përsëritur thyerje të disiplinës dhe nuk i është hequr masa e dhënë më parë;

ç) kur provohet se ka përdorur funksionin e tij në shërbim të interesave vetjake ose të personave me të cilët ka lidhje familjare;

d) kur provohet se me veprimet ose mosveprimet e tij ka krijuar favore të padrejta për persona të

tjerë;

dh) kur nuk përmbush veprimet përmbarrimore të parashikuara në ligj;

e) kur është vlerësuar “i paaftë” në përputhje me pikën 2 të nenit 14 të këtij ligji”.

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim, K.Pr.C.), në nenin 510 të tij ka përcaktuar se, ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv, dhe se, janë tituj ekzekutivë, sipas përcaktimeve të këtij neni:

“a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej

saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;

b) vendimet penale të formës së prerë në pjesën që bëjnë fjalë për të drejta pasurore;

c) vendimet e gjykatave e të arbitrazheve të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi;

ç) vendimet e një gjykate arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë;

d) aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare;

dh) kambialet, çeqet e letrat me urdhër që barazohen me ato;

e) aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbarrimit për ekzekutimin e tyre”.

Në nenin 515 dhe 524, të tij, K.Pr.C, është përcaktuar se: “Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbarrimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbarruesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit...”.

Bazuar në sa më lart, Komisioneri vëren se, Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor, ushtron veprimtarinë e tij, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe

funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor”, të ndryshuar, shfuqizuar me Ligjin nr.8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor” dhe ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe se, personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile është pikërisht përmbarruesi gjyqësor.

Pra, në këtë kontekst, në rastin në fjalë, Komisioneri vlerëson se, nëse përmbarruesi gjyqësor i Zyrës Përmbarrimore Shkodër, (si pjesë e Dhomës Kombëtare të Përmbarruesve Gjyqësorë Shtetëror), nuk ka mundur zbatimin Urdhrin e Ekzekutimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (në përmbushje të zbatimit të vendimit të formës së prerë, që përbënë titull ekzekutiv), pasi palët të cilave u lindë detyrimi për zbatimin e këtij vendimi kanë kundërshtuar ekzekutimin e tij, jemi përpara kushteve të parashikura në nenin 320 të Kodit Penal, **Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës** ku është parashikuar se: *“Fshehja, tjetërsimi, konsumimi, dëmtimi apo shkatërrimi i sendeve për të cilat është marrë një vendim prej gjykatës, ose kryerja e veprimeve të tjera të bëra me qëllim që të mos ekzekutohet ose të pengohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”*.

Bazuar në dispozitat e nenit 320/a, i Kodit Penal, përcaktohet se: *“Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i një vendimi penal ose civil të gjykatës, nga punonjësi i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Kur kjo vepër kryhet me qëllim fitimi ose çdo interes tjetër të dhënë ose të premtuar, si dhe për të favorizuar persona që kanë interes për mosekzekutimin e vendimit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”*.

Në vijim të arsytimit të mësipërm, sqarojmë se nga ana e Përmbarruesit Gjyqësor Shkodër, rezulton që janë bërë disa kallëzime pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, sipas kërkesës nr. 2485, datë 25.07.2023, nr. 1056, datë 28.07.2023, kallëzim i datës 31.07.2023 (Referuar shkresës nr.7622, datë 12.09.2023 të Prokurorisë), nr. 7622, datë 12.09.2023, nr. 1056/1, datë 14.09.2023.

Ndërkohë në ankesë z. Gj. Sh, shprehet se një kallëzim i tillë është bërë nga Zyra Përmbarrimore Shkodër edhe ndaj Komisionariatit të Policisë Shkodër, me shkresën nr. 782 prot., datë 20.02.2023, e cila ka depozituar kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për kryerjen e veprës penale *“Pengim i ekzekutimit të vendimit gjyqësor”* të parashikuar nga neni 320 i K.Penal.

Për rrjedhojë, trajtimi i kësaj kërkesë të ankuesit, nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Komisioneri informon ankuesin se, ankimimi kundrejt veprimeve apo mosveprimit të organeve shtetërore të tilla si Komisionariati i Policisë Shkodër, në rastin konkret, bëhet pranë organeve

kompetente të drejtësisë si, Prokuroria apo Gjykata, dhe shqyrtimi i tyre është jashtë kompetencave të KMD-së.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e çështjeve që janë kompetencë e organeve si prokuroria e gjykata, bazuar në pretendime që lidhen me kundravajtje apo vepra penale të parashikuara në legjislacionin penal të Republikës së Shqipërisë, apo për më tepër kontrolli i vendimmarrjeve të Prokurorisë, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Fakt tjetër i konstatuar referuar dokumentacionit të administruar me këtë ankesë rezulton që për rastin objekt shqyrtimi, me Drejtorinë e Policisë Shkodër ka patur korrespondencë shkresore, e cila daton që në 04.02.2013, me shkresën nr. 68 prot., Përmbaruesi Gjyqësor M. T, ka kërkuar mbështetjen e forcave të Policisë së Shtetit, për ekzekutimin e këtyre vendimeve, kërkesë e cila është përsëritur me shkresën nr. 67 prot., datë 15.02.2013 dhe shkresën nr. 66/1 prot., datë 10.07.2014.

Për këtë rast, është shprehur dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. 779/1 prot., datës 28.08.2020, me të cilën është trajtuar kërkesa nr. 2581/1 prot., datë 06.08.2020 e Komisarariatit të Policisë Shkodër, nëpërmjet të cilës është kërkuar mendim në lidhje me “...mosmbështetjen me forca policore të Përmbaruesit Gjyqësor Privat z. L. C”.

Ky fakt vërtetohet dhe në kthimet e përgjigjeve të Komisarariatit të Policisë Shkodër ku ndër të tjera shprehen se: *...për të qenë sa më objektiv në rastin e çështjes konkrete, ka pasur një korrespondencë shkresore të rregullt, në zbatim të detyrimeve ligjore dhe Proçedurës Standarte të Punës “Për veprimet që kryhen nga strukturat e Policisë së Shtetit”, në rastin e mbështetjes së Përmbaruesit Gjyqësor Privat/Shtetëror, miartuar me Urdhërin nr.136, datë 04.02.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit”. Gjithashtu përmendet dhe shkresa nr. 6886/5, datë 04.12.2020 e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila ka trajtuar çështjen lidhur me veprimet dhe qëndrimin që duhet të mbajë Komisaritati i Policisë Shkodër, përsa i përket kërkesës së Përmbaruesit Gjyqësor për rastin e Gj. Sh.*

Në këto kushte, momenti i marrjes dijeni nga ankuesi mbi sjelljen diskriminuese të pretenduar nga Komisaritati i Policisë Shkodër, rezulton që në datën **04.02.2013** ndërsa data e depozitimit të ankesës pranë KMD-së është **26.10.2023**. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit daton më shumë se 3 (vjet) nga ndodhja e diskriminimit të pretenduar. Njëkohësisht, edhe momenti, i marrjes dijeni mbi diskriminimin e pretenduar, daton më vonë se 2 (dy) vjet nga data e depozitimit të ankesës nr. 230, datë 26.10.2023 pranë KMD-së.

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat*

e këtij ligji” dhe pikën 4/dh të tij, ku është parashikuar se: “Ankesa nuk pranohet kur paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet”.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/b të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ky kërkim i ankuesit nuk mund të pranohet dhe nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e tij,

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 230, datë 26.10.2023, të paraqitur nga z. Gj. Sh, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA